



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale dhe jo kapitale në regjistrin e përgjithshëm të pasurive.
- A2 Komuna kishte paguar faturën në shumë prej 98,235€ deri sa materiali ndërtimorë nuk është pranuar në tërësi nga përfituesit.
- A3 Në aneksin e pasqyrave financiare Llogaritë e Arkëtueshme për mbeturina ishin prezantuar 4,090,393€, duke mbivlerësuar llogarinë për 268,532€.
- A4 Keqklasifikimi i shpenzimeve në shumën 1,809,294€ si pasojë e mos regjistrimit të duhur të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike përkatëse.
- B1 Në raportin vjetor financiar në aneks, përkatësisht në nenin 18, në vitin 2021 ishin prezantuar/ shpalosur detyrime kontingjente në shumën 560,374€ ndërsa në bazë të historiatit të padive aktive do të duheshin të shpaloseshin mbi 10,000,000€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Prizrenit nuk kanë qenë në përputhje me:

Baza për konkluzion

- A5 Përdorimi jo adekuat i kontratës kornizë, më çmime për njësi në vend të formës së sasive të planifikuara (indikative).
- A6 Komuna për shkak të mos pagesës me kohë të faturave kishte shpenzime shtesë të interesit dhe procedurave të gjykatës/ përmbarrimit në shumë prej 844,356€.
- A7 Pagesa prej 121,746€ për kamionin e zjarrfikësve pa raport të komisionit pranues.
- B2 Komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 7,323,931€ apo 1,549 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor sipas nenit 39.1 të Ligjit Nr. 03/L-048 për MFPP.
- B3 Zbatimi i zbritjeve të lejuara nga vlera e njësisë së objektit, është bërë për pronat e personave për të cilët nuk është evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë.
- B4 Për 2,932 amvisëri, faturimi për taksat për mbeturinat ishte bërë në shumën 12 €/ vit, përderisa tarifa vjetore ishte 54 €/ vit. Si rezultat i këtij nën faturimi, të hyrat ishin mbledhur më pak në shumën 123,144€.
- A8 Tejkallim të sasive të përcaktuara me kontratën kornizë në shumë prej 292,415€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Komuna nuk kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria, kjo për arsye se sistemi e-pasuria ende nuk është funksional, në mungesë të saj, të dhënat për pasurinë jo kapitale regjistrohen dhe evidentojnë në formatin excel.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë këtu kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Procesi i raportimit në Komunë është përcjellë me mangësi, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Më tutje, pasqyrat financiare janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA, përveç çështjeve të trajtuara më poshtë të cilat kanë ndikuar në opinion e auditimit.

Në mungesë të kontrolleve të brendshme të duhura në komunë, janë identifikuar disa çështje të cilat kanë ndikuar te opinionin e auditimit dhe konkluzioni i pajtueshmërisë.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 16 rekomandime, prej tyre 9 janë rekomandime të reja, 6 të përsëritura dhe 1 pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Dobësitë në regjistrimin e pasurive

Gjetja

Neni 6 i rregullës MF Nr..01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB përcakton, që Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjisllacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Pasuritë kapitale jo financiare të blera gjatë vitit 2021, ishin në shumën 14,164,936€, ndërsa në regjistrin e përgjithshëm të pasurive kapitale ishin regjistruar 12,234,965€ me një diferencë prej 1,929,971€.

Në mungesë të funksionimit të sistemit e-pasuria, pasuritë nën 1,000€ mbahen në një fletë Exceli. Megjithatë, shuma e prezantuar në pasqyrat financiare ishte mbivlerësuar për 99,855€, si rezultat i saldoeve të gabuara ndër vite.

Sipas informatave nga përgjegjësit e pasurive të gjitha shpenzimet kapitale nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale për shkak të keq-klasifikimeve. Megjithatë, nuk është ofruar ndonjë listë që dëshmon për pasuritë që janë keqklasifikuar.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton menaxhim të dobët të pasurisë, si pasojë ndikon në mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe në prezantimin jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë kapitale dhe jo kapitale. Po ashtu, duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasurisë për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Dobësitë lidhur me pranimin e mallit/shërbimit

Gjetja Rregullorja për shpenzimet e parave publike, në nenin 23 përcakton se, pranimi i mallit/ shërbimit bëhet nga zyrtari/ komisioni i autorizuar. Përveç kësaj, kushtet e kontratës përcaktojnë se pagesat do të bëhen në bazë të furnizimeve të cilat ofrohen nga operatori ekonomik dhe aprovohen nga organi mbikëqyrës.

Për kontratën “Furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnore dhe rasteve sociale”, për 37 përfitues, më datë 16.12.2021 është kryer pagesa në shumën 98,235€, për të cilën komisioni për pranimin e materialit, më datë 10.12.2021, ka konstatuar se materiali është pranuar si në sasi ashtu edhe në cilësi. Dokumenti i pranimit ishte nënshkruar edhe nga mbikëqyrësi kryesor. Sipas ekzaminimit (për shtatë përfitues), kemi vërejtur se në dy raste, materiali ndërtimor nuk ishte dërguar tek përfituesit edhe pse ekziston fletëdërgesa në emër të tyre. Vlera e materialit të paguar dhe pa pranuar të rasteve të ekzaminuara është 10,783€.

Sipas komisionit të pranimin të mallit është nënshkruar raporti për pranim pa verifikuar paraprakisht duke konsideruar se fatura duhet të paguhet me qëllim që mjetet të mos shkojnë si suficit.

Ndikimi Ekzekutimi i pagesave për rastet e cekura më sipër është në kundërshtim me rregullat/ kontratën, po ashtu, rritë rrezikun që përkundër pagesës së materialit të mos furnizohen fare. Në këto raste rrezikohet arritja e vlerës për para dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontrole adekuate/ rigoroze mbi kontratat për projekte kapitale dhe mbi komisionet/organet mbikëqyrëse të punëve/materialit të furnizuar. Po ashtu, menaxhmenti të shtojë mekanizmat për kontroll më të avancuar në mbikëqyrjen e kontratave dhe pagesave për projektet e tilla.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Nënvlërësimi i të arkëtueshmeve për taksat nga mbeturinat

Gjetja Sipas Rregullores së MF-së nr. 1/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, përcakton që OB-të që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të të hyrave.

Të arkëtueshmet nga taksat për mbeturina, të prezantuara në Raportin dhe Aneksin e pasqyrave financiare ishin prezantuar 4,090,393€, shumë e cila

është mbivlerësuar për 268,532€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm efektiv me rastin e prezantimit të të arkëtueshmeve në pasqyra financiare.

Ndikimi Mos prezantimi i saktë i të arkëtueshmeve nga taksat për mbeturinat ka ndikuar në nënvlerësimin e të arkëtueshmeve për këtë shumë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet sistemit për të hyrat nga taksat për mbeturina, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike

Gjetja Neni 18, paragrafi 3, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Bazuar në testet e kryera rezulton se kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim:

- Shpenzimet për subvencione, për furnizim me dru për familjet e skamnorëve, në shumën 55,000€, ishin regjistruar në kategorinë mallra & shërbime në vend që të klasifikohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve;
- Shpenzimet për pasuritë nën 1,000€, në shumë 114,586€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve;
- Shpenzimet e participimeve me fermerët për projekte të ndryshme bujqësore, në shumën 720,185€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek subvencionet dhe transferet; dhe
- Shpenzimet për shujta të punonjësve arsimor, në shumën 85,553€, ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të subvencioneve në vend që të klasifikohen tek kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve.

Keqklasifikimet kanë ndodhur për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

Ndikimi Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/ kategoritë adekuate të buxhetit (apo

të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos prezantimi/ shpalosja e detyrimeve kontigjente

Gjetja

Sipas Rregullores MF nr. 01/2017, Neni 3 1.1. Detyrim kontingjent - është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen; dhe Neni 18 Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Në raportin vjetor financiar ishin shpalosur detyrime kontigjente në shumë 560,374€, përkatësisht shtatë (7) raste të cilat nuk e plotësonin kriterin e detyrimeve kontigjente (pagesa përmes përmbarimit). Bazuar në dëshmitë e ofruara, në vitin 2020 Komuna do të duhej të shpaloste detyrime kontigjente mbi 10,000,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos koordinimit të duhur dhe qartësisht ndërmjet përfaqësuesit (zyrës ligjore) dhe departamentit të financave.

Ndikimi

Mos prezantimi i plotë i detyrimeve kontigjente (padive gjyqësore), shkakton nënvlerësim të tyre, dhe për pasojë mos planifikimin e duhur të buxhetit për mbulimin e detyrimeve financiare në vitin pasues, në rast të humbjes së këtyre kontesteve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë, që detyrimet kontigjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plota mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A5 - Mangësi në kontratën kornizë, mospërdorimi i sasive të planifikuara (indikative)

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP), në nenin 18.27 përcakton se, në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasi të mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikimi i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Sasi të duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit. Ndërsa nenin 56.9 përcakton se, Autoriteti kontraktues nuk mund të përdor kontratat publike kornizë në mënyrë të tillë që të parandaloj, kufizoj, ose ngatërroj konkurrencën.

Komuna kishte nënshkruar për tri vite, nga viti 2021 - 2024, kontratën kornizë "Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit", me çmime për njësi shuma totale e të cilave është 804.96€. Ndërsa vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 1,500,000€. Në kontratë nuk ishin parashikuar sasi të përafërta (indikative), sipas kërkesës ligjore të RrUOPP, përkatësisht nenit 18.7. Përveç kësaj, një parashikim i përafërt ka mundur të bazohej në konsumin e më hershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës.

Sipas komunës, kjo ka ndodhur pasi që nuk është bërë planifikimi i sasive indikative. Megjithatë, kjo reflekton në mungesë të kontroleve të brendshme me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit.

Ndikimi Kontrata më çmime për njësi mund të ndikoj në furnizime/shërbime apo punë të pa parashikuara sipas pozicione/artikujve, pasi që, kontrata në zbatim nuk është e peshuar me sasi indikative të planifikuara.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë, në rastin e zbatimit të kontratave me çmime për njësi, të këtë përdorim efikas të kontratave, ashtu që në proceset prokuruese të përdoren procedurat e duhura të llojeve të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Shpenzime për procedurat përbarimore

Gjetja Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/ përbaruesi.

- Shuma e pesë pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/ përbarimore ishte 528,426€, prej tyre 10,386€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/ përbarimit; dhe

- Për 18 raste, shpenzimet e përmbartimit dhe përfaqësimit të ndodhura për shujta dhe paga jubilarë në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, si rezultat i obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive, ishin prej 833,970€.

Shkaku i realizimit të pagesave me vendime gjyqësore ishte hyrja në obligime pa buxhet, si dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor.

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve ndikon në pagesa që mund të realizohen përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore, e të cilat kanë edhe shpenzime tjera shtesë. Njëkohësisht, këto rrezikojnë edhe realizimin e projekteve të parapara për vitin aktual.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë, që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikim të mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Pagesa e automjetit për zjarrfikës pa raport pranimi

Gjetja Neni 24 i Rregullës 01/2013 MF për Shpenzimet e parasë publike përcakton, që të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat kontrollit të brendshme për qarkullim të dokumentacionit. Më tutje, pika 1.2 përcakton që zyrtari/ komisioni i autorizuar të sigurojë raportin e pranimi të mallit/shërbimit; ndërsa sipas nenit 1.3, fatura duhet të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Më datë 25.02.2021, Komuna kishte lidhur kontratë me Operatorin ekonomik për "Furnizim me automjet special për zjarrfikës", në shumën 119,000€. Operatori ekonomik nëpërmjet procedurës përmbartimore ka kërkuar nga Thesari në Ministrinë e Financave për pagesën e faturës. Fatura ishte e pa nënshkruar nga zyrtarët e Komunës dhe e pa protokoluuar në Komunë. Thesari, më 30.12.2021, kishte realizuar pagesën në shumën 121,746€, përfshirë shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumën 2,746€.

Komisioni i caktuar nga Komuna nuk kishte bërë pranimin e automjetit me arsyetimin se nuk janë kompetent për pranimin teknik të automjetit.

Ndikimi Mos pranimi i automjetit nga komisioni mund të ketë rrezik se automjeti i paguar, mund të mos i plotësoj kushtet dhe kriteret e specifikuar. Më tutje, shpenzimet për përmbartuesin privat e dëmtojnë buxhetin komunal, duke krijuar shpenzime të paplanifikuara të projektit.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i formuar për pranimin e mallit, të jetë me personel kompetent, në mënyrë që të pranoj mallin e porositur sipas procedurave dhe kriterëve të specifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Tejkalim i furnizimeve të sasive të përcaktuara në kontratën kornizë**Gjetja**

Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, përkatësisht Neni 56.10 përcakton, sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull, dhe rregulla financiare nr. 01/2013 neni 22 parasheh hapat e procedimit të pagesës raporti i pranimit të mallit është para pranimit të faturës.

- Bazuar në kontratën kornizë "Sigurimi Fizik loti I" në vlerë totale 703,992€ nga viti 2020 deri me 2023 me çmimin për njësi orë të shërbimit 2,71€ pa deklarimin e devijimit +/- 30%, në aneksin 1, për muaj ka parapa 7,440 orë të shërbimit për 10 lokacione. Bazuar në shpenzimet e analizës së furnitorëve për vitin 2021, ishte paguar shuma 521,770€ apo 192,535 orë pune. Pra, bazuar në aneks kontratë, në periudhën njëvjeçare për vitin 2021 do të realizoheshin 12 muaj*7,440 orë = 89,280 orë pune, ndërsa janë tejkaluara 103,255 orë pune, apo në shumën financiare 279,821€.
- Komuna ka aplikuar kontratën kornizë të AQP-së "Furnizim më bukë dhe brumëra tjerë Kategoria 5 loti II me +/- 30%, por ka tejkalim të pozicionit 2 të Kifle kroasan të kontraktuara 118,200 copë ndërsa vetëm në pesë (5) fatura të paguara është furnizuar me 178,904 copë që ka tejkalim 25,244 copë ose në shumën 3,938€.
- Në kontratën për Transportin e mësimdhënësve udhëtarë, për dy faturat e muajit Mars dhe Maj-Qershor, ka pasur tejkalim për shumën 8,656€ krahasuar me atë të paraparë në kontratë, për arsye të numrit të punonjësve që është shtuar.

Sipas zyrtarëve këto tejkalime kishin ndodhur si pasojë e nevojave shtesë. Megjithatë, kjo duket mungesë e kontrolleve jo adekuate, sepse komuna në procesverbalin e pranimit për mallra, shërbime dhe furnizime i referohet faturës, e jo ndonjë situacioni rendor, që në të, do të paraqiteshin dhe pozicionet përmbledhëse të situacioneve paraprake.

Ndikimi

Procesverbali i pranimit të punëve duke u bazuar në faturë e jo më situacione të implementimit të kontratës, ku do të paraqiteshin dhe pozicionet e vlerat përmbledhëse të situacioneve paraprake, lë hapësirë të mungesës së kontrolleve në përcjelljen e kontratës. Po ashtu, kjo mund të ndikojë edhe në tejkalimin e vlerës së përgjithshme të kontratës.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të sigurojë, që më rastin e pranimit të shërbimeve, furnizimeve të parashihen të gjitha pozicionet/ artikujt përmbledhës të situacioneve paraprake si parakusht i faturimit dhe ekzekutimit të pagesave. Njëkohësisht, të sigurojë se shërbimet/ furnizimet, janë kryer sipas sasisë

dhe vlerës së përcaktuar me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021, ishin kryer pagesa në shumën 7,323,931€ apo 1,549 raste të pagesave ndaj furnitorëve nga lista e marrë, të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor, që kanë rezultuar edhe me pagesa përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e Komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, Komuna mund të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbarimore.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë, që obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësi e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Për 5,103 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - "Zbritjet për vendbanim parësor", mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më

pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 114,817€. Për më tepër, te këta tatimpagues janë 307 prej tyre për të cilët nuk ishte përcaktuar kategoria e pronës.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar “Banimin Parësor” nuk do të zbatohet zbritja e lejuar.

Ndikimi Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga taksat për mbeturina

Gjetja Rregullorja “Mbi menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit”, neni 5.1, përcakton se taksat për mbeturinat do të faturohen dhe inkasohen nga Komuna. Ndërsa, në Shtojcën 1 të Rregullores, përcaktohen tarifat e taksës për mbeturina për amvisëritë në zonën urbane dhe rurale, në shumën 4.5€/ muaj ose 54€/ vit.

Bazuar në të dhënat e Komunës, për 2,932 amvisëri ishte bërë faturimi në shumën 12€/ vit pa ndonjë bazë ligjore, përderisa tarifa vjetore ishte përcaktuar 54€/ vit. Si rezultat i këtij nën faturimi, Komuna do të mbledhë më pak të hyra në shumën prej 123,144€.

Zyrtari përgjegjës i Komunës konfirmon se, faturimi në shumën 12€/ vit, është zbatuar për qytetarët që jetojnë jashtë vendit dhe se një tarifë e tillë ishte praktikë nga vitet paraprake e cila ishte përdorur edhe nga Kompania për mbledhjen e mbeturinave.

Ndikimi Mos azhurnimi i të dhënave sipas gjendjes faktike si dhe mos zbatimi i tarifave të përcaktuara me Rregullore ka ndikim të vazhdueshëm në mbledhjen më të ulët të të hyrave nga taksat për mbeturina.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë, që do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e Komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirim apo përcaktimin e tarifave për amvisëritë e caktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 24,581,854€. Numri i lejuar i stafit sipas buxhetit/planifikimit ishte 3,175 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri ishte 3,089 punonjës.

Çështja B5 - Mos harmonizimi ndërmjet akt emërimit dhe koeficienteve për kompensimin e pagave

Gjetja

Pagesa e stafit duhet të bëhet në bazë të koeficienteve të përcaktuar me akt emërim për pozitën e caktuar.

Në katër raste të testuara, kishte mos harmonizim ndërmjet koeficienteve dhe pozitave në akt emërim dhe listën e pagave si:

Zyrtari për buxhet dhe financa në Drejtorin e Arsimit, sipas akt emërimit kishte koeficientin gjashtë (6), ndërsa në listën e pagave paguhet si zyrtar i lartë për buxhet dhe financa me koeficient tetë (8). Ndërsa, në drejtorinë e kadastrit, tre (3) zyrtar sipas akt emërimit kishin pozitën gjeometër me koeficient pesë (5), ndërsa në listën e pagave figuronin si gjeodet dhe paguhen me koeficientin shtatë (7).

Shkaku i kësaj dukurie ishte mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme për të harmonizuar listën e pagave me akt emërim.

Ndikimi

Mos harmonizimi ndërmjet listës së pagave me akt emërim mund të rezultojë në kompensime të parregullta dhe njëherit në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë, që të gjithë të punësuarit paguhen në bazë të pozitave zyrtare që janë të emëruar dhe të siguroj harmonizimin e akt emërimeve me listën e pagave për të gjithë të punësuarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 8,669,314 €, prej tyre ishin shpenzuar 8,170,451€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për mirëmbajtjen e hapësirave, shpenzime për derivate, furnizime mjekësore, shpenzime komunale, shpenzime tjera në kuadër të administratës komunale dhe arsimit.

Çështja A9 - Pagesa e ekzekutuar pa situacion të pranuar

- Gjetja** Rregulla Financiare MF 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 22 pika 3, përcakton që për të realizuar një pagesë duhet të ketë dhe raportin e pranimit (situacionit).
- Komuna kishte nënshkruar kontratën për "Hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugës nga fshati Jeshkovë deri në shtëpinë malore në Struzhë", në vlerë 11,620€. Situacionet për kryerjen e punëve nuk ishin nënshkruar nga Organi mbikëqyrës. Si pasojë, pagesa është kryer përmes procedurës përbarimore.
- Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së situacionit të pranuar dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve.
- Ndikimi** Mungesa e nënshkrimit të situacionit dhe ekzekutimi i pagesës përmes përbarimit në mungesë të kundërshtimit nga Komuna, tregon mungesë të kontrolleve dhe krijimit të shpenzimeve shtesë përbarimore.
- Rekomandimi A9** Kryetari duhet të shtojë kontrollet me rastin e ekzekutimit të punëve, ashtu që të sigurojë se është bërë pranimi i situacioneve të nënshkruara para pranimit të faturave, dhe të sigurojë se pagesat janë kryer me rregull dhe në kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 492,458,855€, pasurive jokapitale është 2,648,747€, si dhe e stoqeve 303,496€.

Çështja B6 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Rregulla nr. 02/2013, neni 19 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të pasqyrave financiare vjetore.

Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin mbi gjendjen e inventarizimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për realizimin e detyrave të përcaktuara me kohë.

Ndikimi

Mos kryerja e procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjor, rritë rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë. Njëherit, rritë rrezikun e keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre si dhe ndikon në prezantim jo të drejtë në raportimet financiare.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë, që procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna e Prizrenit në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 17,068,540€.

Çështja C1 - Shlyerja e borxheve për mbeturina

Gjetja

Rregullorja “Mbi menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit”, në nenin 3.5 përcakton se, është përgjegjësi e Komunës për të formuar Komisionin në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina.

Bazuar në të dhënat e Komunës, brenda periudhës janar - mars 2021, janë shlyer borxhet për 18 amvisëri në shumën 6,426 €, pa u formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave të taksapaguesve. Kjo praktikë e tillë ishte ndërprerë pas trajtimit të kësaj çështje në auditimin paraprak dhe në zbatim të rekomandimit ishte formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave të taksapaguesve, mirëpo ende nuk kishte filluar me trajtimin e shlyerjes së borxheve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm efektiv me rastin e shlyerjes së borxheve.

Ndikimi

Shlyerja e borxheve pa u trajtuar nga Komisioni i ankesave mund të ketë për efekt shlyerjen e borxheve në mungesë të dhëshmive përkatëse.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni i formuar të rishikoi faturat e shlyera ndër vite dhe të bëjë një vlerësim të gjendjes faktike të borxheve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	47,788,686	55,149,555	50,185,605	44,966,504	42,816,371
Grante Qeveritare - Buxheti	40,614,659	43,471,575	41,768,695	37,528,620	34,815,743
Financimi përmes huamarrjes	0	436,027	311,911	526,542	66,165
Të bartura nga viti i kaluar	0	3,313,003	2,405,653	2,514,548	2,389,112
Të hyrat vetanake	7,174,027	7,174,027	5,382,984	4,199,010	5,203,034
Donacionet vendore	0	723,148	315,934	132,793	121,279
Donacionet e jashtme	0	31,775	428	64,992	221,039

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 7,360,868€ si rezultat i kursimeve nga granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë në shumën 2,856,915€, pastaj i bartjes së të hyrave nga viti paraprak për 3,313,003€, rritjes së fondeve nga huamarrja për 436,027€, si dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshme për 723,148€ dhe i donatorëve të jashtëm për 31,775€. Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit përfundimtar, me një përmirësim 7% në krahasim me vitin 2020.

Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	47,788,686	55,149,555	50,185,605	44,966,504	42,816,371
Pagat dhe mëditjet	20,845,758	24,581,854	24,546,533	20,582,472	19,985,963
Mallrat dhe shërbimet	6,970,550	8,669,315	8,170,451	7,438,923	5,678,409
Komunalitë	1,031,199	1,031,199	741,445	680,450	808,493
Subvencionet dhe transferet	950,000	3,113,289	2,562,240	1,877,050	701,263
Investimet Kapitale	17,991,179	17,753,898	14,164,936	14,387,609	15,642,244

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Si rezultat i rishikimit të buxhetit për paga dhe mëditje, buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,736,096€. Pjesa më e madhe e kësaj rritje është dedikuar për pagesat nga vendimet gjyqësore në shumë prej 3,662,515€;
 - Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 1,698,765€. Buxheti final ishte realizuar në shkallën 94%. Në kuadër të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, Komuna kishte shpenzuar 94,550€ në emër të vendimeve të gjykatave;
 - Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,163,288€, përdorimi i realizimit ishte në masën 82% e buxhetit final. Me vendim të qeverisë nr.22/50, ishte aprovuar kërkesa e Komunës së Prizrenit për transferimin e shumës 539,676€ në llogari të NSH "Kosovatrans", për qëllim të shlyerjes së borxheve ndaj ATK-së, ndërsa pjesa tjetër me rishikim të buxhetit në shumë prej 1,623,612€.
 - Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 237,280€, përkundër këtij zvogëlimi realizimi i buxhetit ishte në shkallën 80%. Po ashtu, dinamika e realizimit nuk ishte në harmoni me planifikimet, sepse 46% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fund vitit. Gjithashtu, vlen të theksohet se nga 197 projekte të parapara, 57 prej tyre nuk kishin filluar fare. Shkaku i një dukurie të tillë ishin pagesa në emër të vendimeve gjyqësore si dhe keq klasifikimeve në projektet kapitale.
- Si rezultat i situatës pandemike me COVID-19, Komuna e Prizrenit kishte shpenzuar 763,014€ për paga dhe mëditje për punëtorët në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Gjatë vitit 2021, komuna ka realizuar të hyra prej 7,952,471, krahasuar me vitin paraprak, të hyrat e realizuara ishin më të larta për 1,972,094€. Përveç këtyre, komuna kishte inkasuar edhe të hyra indirekte të cilat mblidhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 1,283,000€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	7,174,027	7,174,027	7,952,471	5,971,583	6,960,157
Të hyrat tatimore	2,067,725	2,067,725	3,168,586	2,205,372	2,394,259
Të hyrat jo tatimore	5,106,302	5,106,302	4,774,606	3,765,726	4,558,419
Të hyrat tjera	0	0	9,279	485	7,479

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Prizrenit ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna e Prizrenit ka hartuar Raportet periodike për ecurinë e rekomandimeve të ZKA për vitin 2020 dhe atë me datat 30.09.2020 si dhe 15.03.2021. Deri në fund të auditimit për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, shtatë (7) nuk janë zbatuar, një (1) pjesërisht si dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të formojë një komision profesional i cili do të verifikoj faturat e fshira/anuluara për tu siguruar se faturat e fshira/anuluara vërtet kanë qenë gabim bazuar në gjendjen faktike. Po ashtu, duhet të sigurojë se ankesat pranohen përmes zyrës së protokollit dhe se shqyrtimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.	Megjithëse është formuar komisioni për shqyrtim të ankesave, komuna nuk ka marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirim apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.	Edhe këtë vit kemi faturime në kundërshtim me rregulloren në fuqi.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj marrjen e masave për largimin e shfrytëzuesve ilegal nga pronat publike, arkëtimin e borxheve dhe më pastaj dhënia e pronës publike me qira të realizohet sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092.	Vendimin e Komunës për largimin e shfrytëzuesve ilegal e ka pezulluar Gjykata.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj që të gjithë të punësuarit paguhen në bazë të pozitave zyrtare që janë të emëruar dhe të sigurojë harmonizimin e akt emërimeve me listën e pagave për të gjithë të punësuarit.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se zhvillimi i procedurave të rekrutimit bëhet në pajtim të plotë me kërkesat ligjore, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të siguroj aplikimin e procedurave të duhura të prokurimit duke rritur konkurrencën në mënyrë që kontraktimi i mallrave/furnizimeve të bëhet me çmime dhe cilësi konform kushteve të tregut.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që ka transparencë në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriteve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve. Çdo ofrues i mbështetjes financiare (komuna) që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat ligjore. Komisioni Vlerësues të përbëhet nga anëtarë që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, në të kundërtën duhet të zbatohet parimi i llogaridhënies për shfrytëzimin e këtyre fondeve.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar

9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve në mënyrë që të eliminohet praktika e pranimit të mallit dhe punëve pa zotim të mjeteve.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikimi i mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik. Aty ku është e nevojshme, të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të sigurojë që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuar, harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe i paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plotë mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.	Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
15.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetoren dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmburimit.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fitim Haliti, Udhëheqës i ekipit



Hysen Boqolli, Anëtar i ekipit



Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	 REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA KOSOVA CUMHURIYETI Komuna e Prizrenit • Opština Prizren Prizren Beledijesi Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine Belediye Başkanı	
Republika e Kosovës Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti	01 Nr. 083/22 Dt. 30.05.2022	Komuna e Prizrenit Opština Prizren – Prizren Beledijesi

LETËR E KONFIRMIMIT
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetar i Komunës
Shaqir Totaj

Data: 30.05.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.